



VENDIM PËR HEQJEN NGA LISTA TË ANKESËS

Data e miratimit: 14.09.2011

Nr. i rastit: 2011-04

Besim BERISHA

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 14 shtator 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, kryesues
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Asistuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore
Znj. Stephanie SELG, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 22 shkurt 2011.
2. Me 8 qershor 2011 Paneli ka vendosur që ta njoftoj Shefin e Misionit (ShM) të EULEX-it në Kosovë rreth kësaj ankese, duke e ftuar atë që

t'i dorëzoj vërejtjet me shkrim lidhur me ankesën. U vendos që të shqyrtohet bazueshmëria e ankesës, Rregullorja 30, paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores së Punës së Panelit (më tutje RrP).

3. Vërejtjet e ShM lidhur me pranueshmërinë e ankesës janë pranuar me 24 gusht 2011. Më pas ato ishin përkthyer dhe dërguar parashtruesit të ankesës për vërejtje shtesë nga ai. Parashtruesi i ankesës ishte njoftuar se nëse ai nuk do t'i përgjigjej letrës, atëherë Paneli mund të konsideroj se ai nuk kishte ndërmend që ta vazhdonte ankesën e tij.
4. Parashtruesi i ankesës nuk kishte kontaktuar Panelin brenda afatit të paraparë.

II. FAKTET

5. Faktet e paraqitura më poshtë janë marrë prej të dhënave që i kanë ofruar palët.
6. Parashtruesi i ankesës ishte një i burgosur në burgun e Dubravës. Ai pretendon se është duke qëndruar në Pavijonin nr. 3 të burgut për më shumë se 14 muaj. Ai pohon se në Pavijonin 3 mund të qëndrohet më së shumti deri në gjashtë muaj sipas rregulloreve në fuqi të burgut.
7. Përpos afatit të stërzgatur sa ai ka qëndruar në Pavijonin 3, ai ankohej edhe rreth kushteve jashtëzakonisht të vështira në këtë Pavijon, që sipas mendimit të tij nuk i përmbushin qoftë edhe standardet më të ulëta të jetesës.
8. Ai pohon se Pavijoni nuk ka ngrohje gjatë muajve të ftohtë të dimrit, pasi nuk ka karburant. Qelitë kanë lagështi me myk, nuk ka ujë të ngrohtë dhe dushet asnjëherë nuk janë në rregull.
9. Ai gjithashtu pohon se ushqimi që shërbehet për të burgosurit është nën cilësinë e pranueshme dhe se ushqimi është shërbyer nga pjata të përbashkëta që ka rritur rrezikun e sëmundjeve për shkak të higjienës së dobët dhe faktit se të burgosurit që janë të sëmurë hanë ushqim së bashku me të burgosurit që janë të shëndoshë.
10. Sipas njoftimit që kemi pranuar nga ShM, parashtruesi i ankesës është liruar nga burgu i Dubravës me urdhër të Gjykatës Supreme më 26 prill 2011.

III. ANKESAT

11. Nga faktet që paraqiten në këtë rast mund të supozohet se parashtruesi i ankesës pretendon se ka pasur shkelje të Nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriu

(KEDNj, 1950), në atë masë sa ajo e ndalon trajtimin çnjerëzor dhe poshtërues.

12. Gjithashtu ai ankohet për korrupsion dhe keqmenaxhim të dyshuar në mesin e personelit të burgut. Ai pohon se të burgosurit në Pavijonet nr. 3 dhe nr. 5 duhet të paguajnë të paktën 500 deri në 1.000 Euro për tu zhvendosur në kushte më të mira në pavijone të tjera, pavarësisht përmbushjes së kriterëve për tu zhvendosur. Marrëveshje të tilla në të holla supozohet se ekzistojnë sa i përket marrjes së pushimit për fundjavë dhe lirimit eventual me kusht.
13. Parashtruesi i ankesës kërkon që Paneli të rekomandoj themelimin e një komisioni për të shqyrtuar gjendjen e përgjithshme dhe kushtet e jetesës së të burgosjeve në Burgun e Dubravës.

IV. LIGJI

14. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos se a do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriterin për pranueshmëri të përcaktuar në Rregulloren 29 të Rregullores së Punës.
15. Sipas Rregullës 25, paragrafi 1 i Rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë, gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
16. Në vërejtjet e tij, ShM ka deklaruar vetëm se kjo ankesë bie jashtë mandatit ekzekutiv të EULEX-it. Nuk është ofruar asnjë vërejtje tjetër apo argument për ta mbështetur këtë deklaram. Në veçanti, nuk është ofruar asnjë informatë rreth përfshirjes së EULEX-it në administrimin e sistemit të burgjeve të Kosovës, nëse ka ndonjë.
17. Prandaj Paneli e konsideron të përshtatshme që të lihet e hapur çështja nëse mandati ekzekutiv i EULEX-it i prek në këtë rast çështjet në fjalë.
18. Më tej vihet në dukje se parashtruesi i ankesës nuk i është përgjigjur letrave të Panelit dhe nuk ka dorëzuar përgjigjen e tij për vërejtjet e ShM. Ai është njoftuar se nëse nuk përgjigjet, Paneli mund të konkludoj se ai ka humbur interesimin për vazhdimin e rastit. Sipas kësaj që u përmend më lart, Paneli konsideron se parashtruesi i ankesës ka humbur interesimin për ta vazhduar ankesën e tij. Sa i përket respektimit të të drejtave të njeriut nuk është gjetur asnjë arsye që hetimi i mëtejshëm i rastit të jetë i domosdoshëm.
19. Sidoqoftë, Paneli njofton se asgjë nuk e pengon parashtruesin e ankesës për ta ri-parashtruar ankesën e tij në Panel brenda gjashtë (6) muajve nga data e fundit e shkeljes së vazhdueshme të dyshuar të të drejtave dhe lirive të tij themelore të njeriut.

PËR KËTO ARSYE, Paneli njëzëri,

vendos që këtë ankesë ta heq nga lista e rasteve (Rregullorja 46 e RrP).

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Antonio BALSAMO
Kryesues i Panelit